



17 maj 2017

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### **AKP institucioni i parë i pavarur që i bashkohet nismës së UNDP kundër korrupsionit**

**Prishtinë** – Agjencia Kosovare e Privatizimit me kërkesë të Drejtorit Menaxhues z. Ekrem Hajdari i është bashkuar Iniciativës së UNDP-së për Planin e Integritetit Kundër Korrupsionit me ç’rast ka zhvilluar edhe punëtorinë e parë si hap fillestar drejtë kësaj iniciative.

Në përputhje me objektivën strategjike të Bordit për ngritje të transparencës dhe luftim të korrupsionit, menaxhmenti i AKP-së ndërmori këtë nismë në shërbim të masave strategjike parandaluese, në identifikim të rreziqeve dhe vlerësim të tyre.

Menaxhmenti i AKP-së, në vazhdimësi ka ndërmarr hapa si në përmirësimin e imazhit rritjen e transparencës dhe rregullatives së brendshme për parandalimin dhe minimizimin e rreziqeve që mund të cenojë kredibilitetin e Agjencisë si institucion.

AKP është institucioni i parë i pavarur që me vet-iniciativë i është bashkuar kësaj nisme të UNDP-së dhe zotohet se do të vazhdoj tutje me krijimin e mekanizmave parandalues për luftimin e fenomeneve negative në punën e saj.

**FUND**